

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë', denoncimi i elektrikistit të OSHEE: Veglat i blejmë vetë!
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392314.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 18:23:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 18:09:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 18:08:00 UTC → 17 shtator 2026, 18:10:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0da2466f6350094b43ebba9dfb956e081db126e84bfda751b03718922d955505
TEKSTI	f4315a68bec9669743b04fe0d8d428b63b6b3f5b29d1744c160f0d8e7e364642
PAMJA	cddcd4bf29036c65953f4ca6e7b8dfabe4e45de0ed360dba6b494c2735af88e9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	941090c041f16a39668d7277d76b86cf6d3d6dfdd3f648a5f5bd6c996e35dd63
E MËPARSHMJA	fc45a5a948cc4a1dd986f4c2f5915b0e4781c005f873b72bf2804e0caab7e9c2
RRËNJA MERKLE	dd1267ef168833862ec5458d6ebd651bdeec8985e991f38f39b7c2b63c1524a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/941090c041f16a39668d7277d76b86cf6d3d6dfdd3f648a5f5bd6c996e35dd63>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

'Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë', denoncimi i elektrikistit të OSHEE: Veglat i blejmë vetë!

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 17.09.2026, 20:09



Share



Share



"Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë në muaj dhe duhet të jemi gjithmonë gati për çdo problem", shkruan një elektrikist i OSHEE-së në një denoncim të mbërritur në redaksinë e JOQ Albania, duke ngritur shqetësime për pagën, kushtet e punës dhe pajisjet e sigurisë.

Punonjësi, i cili ka zgjedhur të mos bëjë publike identitetin, thotë se shumë prej elektrikistëve përballen çdo ditë me rrezikun në terren, ndërsa sipas tij detyrohen të blejnë vetë një pjesë të veglave që përdorin gjatë punës.

"Ka shumë elektrikistë që jetojnë me qira në Tiranë ose kanë kredi dhe me atë pagë qesharake 64 mijë lekë nuk dalin për asgjë. Veglat detyrohemi t'i blejmë vetë, plus rreziku me të cilin përballemi", shkruan ai.


Sipas tij, problem mbetet edhe pajisja me uniforma dhe masa mbrojtëse. Punonjësi pretendon se mungojnë pajisjet e nevojshme dhe se ekziston frika që punonjësit të penalizohen për mungesën e uniformave, edhe pse, sipas tij, vetë kompania nuk i pajis në mënyrën e duhur.

"OSHEE nuk interesohet as për masa mbrojtëse, as për asgjë. Një ditë mund të gjejnë pretekst edhe për të na hequr nga puna pse nuk kemi uniforma", vijon denoncimi.

Shqetësimet për pagat e elektrikistëve të OSHEE-së nuk janë të reja. Në vitin 2023, drejtuesit e kompanisë dhe ministria e atëhershme e Infrastrukturës dhe Energjisë deklaruan se paga e elektrikistëve të terrenit do të rritej në 70 mijë lekë, nga rreth 50 mijë lekë, ndërsa do të aplikohet edhe shtesa për vjetërsinë në punë.

Edhe në mars të këtij viti, një tjetër punonjës i sektorit të energjisë pretendoi publikisht se rritja e premtuar nuk ishte reflektuar për shumicën e stafit. Ndërkohë, OSHEE Group ka njoftuar për rritje të pagës bazë për punonjësit me profil elektrik, me 7,500 lekë për ata me arsim të mesëm profesional dhe 12,500 lekë për inxhinierët elektrikë, nga 1 shkurti 2026.

Sa i përket pajisjeve të punës dhe sigurisë, dokumentet publike të prokurimeve tregojnë se OSHEE ka zhvilluar procedura për blerjen e uniformave dhe pajisjeve të sigurisë, ndërsa vetëm në qershor 2026, OSSH Berat zhvilloi një tender me fond limit rreth 4.05 milionë lekë për blerje veglash pune për



Më të Lexuarat



Albania për
Media Etive

ARTIKULL JOETIK?

punonjësit e terrenit.

Kjo ngre një pyetje konkrete: nëse pajisjet, uniformat dhe mjetet e punës prokurohen nga kompania, sa prej tyre mbërrijnë realisht te elektrikistët që dalin çdo ditë në terren?

Elektriciisti që iu drejtua JOQ Albania kërkon që zëri i kësaj kategorie të mos dëgjohet vetëm kur ka probleme me furnizimin me energji, por edhe kur bëhet fjalë për njerëzit që dalin në terren për t'i zgjidhur ato.

JOQ Albania mbetet e hapur për reagimin e OSHEE/OSSH-së lidhur me pagat aktuale të elektrikistëve, pajisjet e sigurisë, uniformat, veglat e punës dhe kushtet në të cilat punojnë ekipet e terrenit.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt